

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.07.2025, ora 12:15 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Mirëseerdhët në mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak. Për pak do të vij dhe Kryetari. Ftoj sekretarin të bëj apelin.

Sokol Sinani-Sekretar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Z. Sokol Sinani bën apelin, prezent në sallë janë 36 antarë.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës.

Pika e parë e rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës.

Këshilli Bashkiak me 36 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.07.2025, ora 12:15 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 2 e rendit të ditës

2. Miratimi I proçesverbalit Datë 30.05.2025

Këshilli Bashkiak me 29 vota pro,- kundër, 2 abstenim, miraton sa më sipër.

(D.Çepa;E.Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.07.2025, ora 12:15 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 3 e rendit të ditës

3. Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I Bashkisë për Muajin Maj 2025

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Është nevoja ta relatojmë ?Ka ndonjëri ndonjë pyetje?

Dritan Çepa-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Në rast se do kishte një konsultim,një relativim nuk është keq

Rexhep Kaculi- Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Të gjitha rastet janë parë, nga komisioni vet. Skemi çfarë të relatojmë gjë. Unë them ti hedhim në votim

Këshilli Bashkiak me 34 vota pro, - kundër, 2 abstenim, miraton sa më sipër.

(A.Shtylla;E.Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.07.2025, ora 12:15 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 3.1 e rendit të ditës

3.1 Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar për Muajin Maj 2025

Këshilli Bashkiak me 34 vota pro, - kundër, 2 abstenim, miraton sa më sipër.

(A.Shtylla;E.Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.07.2025, ora 12:15 në ambjentet e qëndrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kalojmë tek pika 5 sa të vijë kryetari. Këtu është përfaqësuesja e buxhetit. Materialin e keni të gjithë me email pasi ka shumë volum

Pika 5 e rendit të ditës

5. Miratimi i programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 (Faza e parë)

Emanuela Beluli-Përfaqësues I Administratës

Në muajin prill u miratuan tavanet e shpenzimeve ndërsa sot është faza e parë, është detajimi i tavanëve. Në këtë fazë të parë janë ruajtur nivelet e pagave të këtij viti po ashtu dhe të shpenzimeve, ndryshime ka vetëm në zërat e investimeve. Në investimet e këtyre viteve janë reflektuar dhe investimet me disa vite financim. Në tre vitet e ardhshme është ruajtur niveli i shpenzimeve të miratuara më parë dhe në këtë fazë të parë ju keni mundësi që nëse juve jeni për lëshime, këto lëshime miratohen në muajin korrik ku miratohen edhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve dhe pastaj në muajin Shtator afatmesmi përfundimtar 2026-2028. Nëse keni ndonjë gjë?

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Zoti Shefqet si përfaqësues ke ndonjë gjë?

Shefqet Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Jo nuk kam

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kush është pro?

Këshilli Bashkiak me 27 vota pro, - kundër, 4- abstenim, miraton sa më sipër.

(E.Muzhaqi;A.Shtylla;D.Çepa;L.Hasa)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja

Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.07.2025, ora 12:15 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 4 e rendit të ditës

4.Mbi miratimin e listës emërore të familjeve përfituese të programit social "Subvencionim I interesave të kredisë "për vitin 2025,financuar me fonde të buxhetit të shtetit

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Në sallë kemi kryetarin dhe përfaqësuesen drejtoreshën përkatëse

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Përshëndetje.Në fakt është një lajm I mirë që ne rihapim kredinë e butë që është një program social për çiftet e reja,për familjet e reja,për ato të cilat kërkojnë një mbështetje.Është një program I mirë I cili I vjen në ndihmë qytetit dhe çifteve të reja për tu stabilizuar me një banesë të tyre private me një kredi të butë e cila jepet në bankat e nivelit të dytë.Programi është hapur që në fillim të vitit në fakt por ka patur një problematikë për sa I përket çështjes ligjore.Ashtu siç e dimë të gjithë pagat në vitin 2024 janë rritur,kanë pësuar një rritje 20-25 deri 30% në disa raste kur kan qenë të ulta kanë kaluar edhe 45%,kryesisht edhe ato të administratës vendore por edhe ato të mësuesve,infermierëve,mjekëve .Në fakt baza që futet që merren të dhënat që futen në formulë,është e dhëna nga Instati e vitit 2023.Kemi patur një korrespondencë të gjatë me institucionet,me Ministrinë e Ekonomisë e cila është Ministria përgjegjëse por edhe me Instatin për të dhënat të sakta të vitit 2024 gjë që të cilën Instati nuk e ka,mund ta japi në vitet e tjera.Në Dhjetor te vitit 2024 ka nxjerrë për vitin 2023,në Dhjetor te 2023 ka nxjerrë për 2022 dhe në fakt të dhënat që janë future aty janë future në bazë të pagave të vitit 2023.Kjo ka patur një ulje të numrit,duhet të themi të vërtetën që ne kemi kuota,kemi kuota të lira,për bonusin e qerasë.Ligjërisht komisioni ka vendosur një listë aq sa jep Këshilli,sa jep të dhënë mesatare sa ka sjellë Instati ndërkohë që bankat e nivelit të dytë aty ku në fakt merren edhe kreditë pasi jo të gjithë emrat që ne miratojmë, miratohen nga bankat e nivelit të dytë në kredidhënie.Pjesa më e madhe e këtyre janë skualifikuar për shumë arsye,mund të kenë pasur një kredi të keqe më parë,mund të kenë patur të ardhura mbi nivelin e caktuar sipas udhëzimit të Ministrisë së Ekonomisë.Në përgjithësi Bankat e nivelit të dytë e mbajnë vet një nivel 20 % më shumë tek lista pra edhe kur miratohet e gjithë lista me të gjithë emrat ato e kanë një valvul presioni të vetën.Në fakt ne kemi sjellë 3 lista 3 propozime,I pari është skualifikimet për efekt të dokumentacionit ligjor,jan ato që nuk kanë patur dokumentacionin e duhur ligjor dhe komisioni I ka skualifikuar.Lista e dytë në total ka qenë lista që ka patur dokumentacionin ligjor të rregullt dhe brenda dokumentacionit ligjor që ka qenë në rregull është bërë në bazë të kriterit ekonomik.Është bërë lista e parë që është në bazë të kriterit ekonomik sipas të

dhënave të sjella nga Instati për vitin 2023 jo për vitin 2024 as për vitin 2025 ose me një parashikim që do të ketë pasur rritje të këtij viti në 2025 të pagave por ka qen ajo e 2023.Në të gjitha rastet ato që kanë kaluar kriterin ekonomik pra që kanë patur mbi ngarkesë të ardhurash janë futur tek lista e dytë.Kjo është ajo që është në material,kjo është ajo që ka vlerësuar komisioni,është një gjë e mirë në fakt që kreditë e buta I japin një zhvillim qytetit dhe ekonomisë së tij,ka një qarkullim më të madh ekonomik,ka një qarkullim më të madh të stokut të banesave që ne kemi në qytet.Ka një efekt social pozitiv për të gjithë çiftet e reja pasi stabilizohen në Elbasan dhe kanë mundësi të zgjedhin vet banesën e tyre,lagjen përkatëse apo zonën përkatëse që do blejë shtëpinë e re,nga ana tjetër çiftet e reja I mbajmë në Elbasan,nuk shohim për të lëvizur jashtë Elbasanit.Do I kërkoja Këshillit Bashkiak të vlerësojë mundësinë edhe të listës ekonomike në bazë të kriterëve të vlerësimeve që mund të jenë debat në komisionet që keni patur.Faleminderit!

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Faleminderit Z.Kryetar.Fjala për kryetarët e komisioneve

Enerieta Ferra – Zv.Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Përshëndetje.Duke parë të arsyeshme të gjithë listën,unë them ta miratojmë të gjithë sepse ky indeks është përlllogaritur me 4 pagat e vitit 2023 kështu që kuota ka të lira pse mos ta miratojmë,ne tja lem bankës ta bëj diferencën duke qen se ka kuota të lira,që të marrin të tërë kush e përfiton.Cmimet e shtëpive janë ku e ku kështu që prap...unë jam e mendimit që ta miratojmë të gjithë listën,edhe ato që e kanë fituar por edhe ato që e kanë kriterin ekonomik te kaluar.

Zamir Muzhaqi – Zv.Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Përshëndetje,në mbledhjen e komisioneve patëm një diskutim për këtë çështje sidomos për çështjen e listës së dytë.Lista e parë ok I kaluar kriteret,për pjesën e listës së dytë pati disa mendime dhe unë personalisht kërkoja një ndihmë nga ana juridike sepse kam mendim që dhe mund ta shtojmë listën duke patur parasysh që të ardhurat llogariten nga viti 2023 dhe doja ndihmën sot,ja lashë si detyrë atë dite,ja thashë edhe kryetarit që kemi mundësi nga ana ligjore që a mundet Këshilli Bashkiak ta anashkalojë ligjin e Ministrisë për këtë çështje?Pra a mundet që ta rishikojmë listën e dytë dhe ta fusim në plan listën e dytë,do doja një përgjigje ju lutem

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Në fakt aty ka dy kritere,kriteri I parë është kriteri ligjor që kush është te pjesa e listës së dytë e ka plotësuar kriterin ligjor sipas komisionit pra kriteri ligjor është në rregull.Kriteri ekonomik bëhet në bazë të formulës,pra është një formulë e sjellë nga ministria dhe të dhënat që futen në formulë të nxjerrin automatikisht ,psh I pari në listë që është skualifikuar është me një vlerë shumë të ulët me 1.000 lekë të reja është skualifikuar që në fakt po të jetë te pjesa e kriterit dmth me rritjen ekonomike që ka pësuar vendi,me rritjen e pagave e përfiton

Zamir Muzhaqi – Zv.Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

E kuptoj prandaj dhe e bëm diskutimin po dua nga ana ligjore a mundemi ne si Këshill ta anashkalojmë VKM?Sepse kam përshtypjen ky ishte diskutimi

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

VKM-ja ka vën kriteret ligjore dhe ka dhënë një formulë ekonomike,të dhënat që I fut ti formulës,I marrim diku ne të dhënat,do I marrim se ne si kemi të dhënat,pra nga Instati dhe e kemi vonuar këtë sepse Instati në thelb të thotë unë nuk e kam këtë të dhënë e vitit 2024,fillojn e bëhen gati nga Shtator deri në Dhjetor 2025.Për të ardhurat e 2025 duhet të presim vitin tjetër e kështu me rradhë.Është një e dhënë e formulës,në qoftë se jam I saktë sepse ktu kam edhe drejtoreshën përkatëse pra kjo është si kriter pastaj ajo është vullnet politik.Në qoftë se ne,ligji formulat,kriteri ligjor kto janë plotësuar të gjitha pra kriteret ligjorë,ktu po flitet per kriter ekonomik,në bazë të formulës,kjo është.Ne duhet të marrim një vendim,ju duhet të merrni një vendim të gjithë bashkë,ose do e miratoni,në thelb mesa informacione kemi ne,me kontaktet që kemi patur me drejtuesit e bankave të nivelit të dytë të Elbasanit nak an thën që ato I miratojnë deri në 20% pra 20% mbi të ardhurat I miratojnë vetë,ça është 30% I skualifikon vetë ai.Ndërkohë ne jemi para një dileme sot që duhet të marrim një vendim,kuota të lira kemi pra nuk është se nuk kemi kuota të lira dhe ti themi ministrisë që nuk kemi kuota ose na jep kuota të tjera.Kuotat I kemi dhe kemi një kërkesë për plotësim ose do ti hapim në një moment të dytë dhe do e shtyjme të gjithë këtë pjesën ose në vitin 2025 do hapim kritere të tjera do hapim listë tjetër

Zamir Muzhaqi – Zv.Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ky qe diskutimi dhe unë prapë nuk jam I qartë.E kuptoj që pjesa më e madhe e kritereve është plotësuar.Një nga kriteret është ministria ka vën dyshtemenë edhe tavan të vetën dhe nëse kalon tavanin pra edhe sikur me 1.000 lekë të reja atëhere nuk e përfiton.U bisedua dhe u diskutua që ne si këshill mund ta anash kalojmë këtë por unë e dua përgjigjen nga ana juridike që mos marrim vendime të pasakta dhe të kota nga ana juridike pra a e anash kalojmë dot këtë apo jo dhe mesa shoh prapë nuk e kemi përgjigjen nga ana juridike

Ilirjan Sadiku-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Më fal po përse duhet të hyjmë ne në këtë lloj gjëje ne?Ne I dërgojmë shkresë ministrisë dhe presim përgjigjen.

Zamir Muzhaqi – Zv.Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

I është dërguar shkresë ministrisë,ka ardhur përgjigjja nga ministria dhe nuk e ka kaluar ministria

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Ministria na I ka alokuar kuotat që kemi pas të vjetrat

Zamir Muzhaqi – Zv.Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Nuk flasim për 86 që kanë kaluar.Derisa mundësitë janë për më shumë atëherë le tja japim këtë mundësi .Ishin me bon sens të gjithë që tja japim këtë mundësi dhe unë e pata një propozim në fakt po e doja një përgjigje që prapë nuk e mora sot por e kam një propozim që ne nëse nga ana ligjore nuk e anashkalojmë dot VKM-në atëherë ne mund të marrim një vendim sot,ky është mendimi im parimisht që mund të shtyj listën e dytë pra një listë e dytë pa I hyrë në hak 2026-s nga janari që ti rishikojmë prapë këto derisa të na vijë lista e re nga Instati që do të rishikojmë të rrisim kuotën sepse e patëm në diskutim këtë kryetar ,ishin të gjithë me bon sens përderisa ka vende dhe ka kërkesa sepse po ti shikoni faqja e dytë ka kërkesa më shumë se faqja e parë dhe hajde ta shtojmë si listë.Unë besoj nga ana ligjore që ne sot nuk mundemi ta shtojmë,sepse kam një javë e gjysëm unë që them ku është përgjigjja nga ana ligjore dhe nuk më vjen

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Është një vendim politik që duhet marrë,nuk është një vendim ligjor.Vendimin ligjor e ka sjellë komisioni.Ne jemi politik bërësit e qytetit dhe vlerësoni a ka interes më të madh sesa kjo,ka një llogjik gjëja kemi interes ne si qytet që ti përdorim edhe kto 70 kuota,të kemi 70 shpia të shitura,70 familje të sistemuara në Elbasan apo do ti djegim kto 70 kuota dhe do presim vitin tjetër,vitin tjetër e me rradhë.Ose nëse ministria na I heq dhe ja kalon një bashkie tjetër?Kto nuk janë paratë tona,nuk është e jona ky si program,është programi I Ministrisë

Enerieta Ferra – Zv.Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ne e miratojmë dhe Ministria të bëj punën e vet

Zamir Muzhaqi – Zv.Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Se miratojmë dot ne se na I kthen e bëhemi ne palaço .Jemi në të njëjtën linjë ,puna është që a e kalon dot këshilli apo se kalon dot?Nëse se kalon dot këshilli marim parimisht një vendim që ta rishikojmë herën e dytë

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Atëherë kalojmë projekt vendimin e ardhur nga drejtoria përkatëse e cila ka të bëjë me 86 emra,duhet miratuar ajo dhe pastaj kalojmë tek diskutimi që ne filluam .Ka një projekt vendim I ardhur nga drejtoria përkatëse,e kalojmë projekt vendimin e drejtorisë përkatëse pastaj flasim për pjesën tjetër sepse ne nuk mund ti penalizojmë të gjithë

Dritan Çepa-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pyetja e parë është për kryetarin-Kto 70 kuota të lira janë të vlefshme për vitin buxhetor kalendarik pastaj në janar nuk ekzistojnë më?

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Çdo vit që ne hapim psh ne këtë vit nuk e kishim 156 a 170 kuota sa kemi,e kishim shumë herë më të vogël,morëm kuotat e vjetra që kishim dhe na dha të drejtën ministria që të transferojmë kuotat e vjetra pra ato që nuk janë përdorur nga projekti I parë.Nuk e dimë nëse vitin tjetër ministria na I transferon apo jo është vullnet politik I ministrisë dhe unë nuk e kam të qartë sot që të them do më transferohen kto për vitin tjetër apo jo.Sot I kam kto kuotat

Arba Suli-Përfaqësuese e Administratës

Unë doja të shtoja diçka kryetar që diskutuam edhe në komision. Përsa I takon kuotave të lira dhe transferimit të tyre dhe pse zotëria kërkonte që këto kuota të rishiheshin në vitin 2026 mirëpo ndryshojnë kriteret, ndryshojnë të ardhurat, ndryshojnë dhe përbërjet familjare të aplikuesve dhe dokumentacioni tekniko ligjor që duhet të dorëzohet për të aplikuar e ka afatin vetëm 3 muaj. Domethënë nuk mund ta marrim këtë listë të 70 dhe ta kalojmë për rishikim në 2026, kjo ishte nga ana tekniko ligjore. Në çeljen e programit korent aktualisht në 2025 ne na janë caktuar 85 kuota dhe vetëm më pas ministria solli një shkresë dhe tha kuotat e lira të viteve të mëparshme ju mund ti përdorni brenda këtij viti kalendarik. Ne nuk e dimë nëse vitin tjetër kur të çelet programi këto kuota do të na ataçohen që ti bashkohen votave të përcaktuara apo jo, apo thjesht do të kemi një numër kuotash fikse. Në 2021 psh I kemi patur kuota fikse, nuk kemi patur kuota të mbartura

Dritan Çepa-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Propozimi im është ky, ne nuk e kemi sigurinë që ministria na e transferon në 2026 këtë fond, këto kuota të lira që kemi aktualisht. Elbasani ka nevojë edhe pse mos I ndihmojmë ato familje që plotesojnë këto kriterë ligjore. Unë personalisht propozoj që këtë listën e dytë me 76 persona që nuk justifikojnë kriterin ekonomik të VKM-së aktualisht, meqë kryetari përmendi që deri në Dhjetor Instati do ta ketë një azhurnim të pagës së 2024-s, ne ta miratojmë këtë listë pritje. Drejtoria përkatëse të kërkoj rifreskimin e dokumentacionit meqë zonja tha tremujori I fundit duhet të jetë I vlefshëm dokumentacioni pastaj nëse Instati nuk e ka publikuar listën akoma të pagave, kjo listë nuk është në fuqi, nuk ka fuqi ekzekutive. Ky është propozimi im që ne mos ti djegim këto kuota, të kemi një listë të miratuar nga Këshilli Bashkiak. Nëse teknikisht dhe ligjorisht është e mundur që tremujorin e fundit të 2025 përse mos ta shfrytëzojmë që të jenë përfitues sa më shumë familje në Elbasan. Të paktën ky është propozimi im llogjik.

Arba Suli-Përfaqësuese e Administratës

Duhet ta kuptojmë qartë që nuk është vetëm problem I dokumentacionit, është problem që në momentin që Instati do të sjelli të gjitha të dhënat e 2024, fillon programi I ri për ministrin dhe çelja fillon në Janar, e kupton dhe ne duhet tju

drejtohemis sërisht ju për pikëzimin për kriteret dhe kto nuk mund të quhen më kuota që janë në pritje,kto janë kuota ose që do miratohen brenda 2025 ose do digjen.Nuk e di sa e qartë jam?Dmth në momentin që Instati në Dhjetor do të sjelli koeficientët e 2024,ministria sjell shkresën dhe e hap programin me kuotat përkatëse me vitin 2026 dhe nuk meret më parasysh mbartja e kuotave

Eva Bica-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Unë kam një propozim,po në qoftë se ne ndërhyjmë në vendim ku kemi vendosur kriterin ekonomik,kriteret.Pse jo?VKM-ja vendos nivele.Në qoftë se ne kriterin ekonomik ka hapësirë sepse aty është nga 100 deri në 120% të të ardhurave mesatare,tani në qoftë se drejtoria....e kemi në nivelin maksimal ne?Atëherë tërhiqem

Luiza Popja-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Zoti Kryetar unë kisha një pyetje,mesa kam parë te kjo lista që është skualifikuar për kriteret ekonomike,ka ndryshime të dukshme.Ky niveli maksimal I të ardhurave që ne kemi përcaktuar në bazë të ligjit që është 120% e të ardhurave sipas përbërjes familjare,mund të ketë një limit që mund ta vendosim që ta rrisim ne psh 70.000 apo 100.000 që të ketë një rikualifikim tjetër.A kemi ne të drejtë ta bëjmë këtë?

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Kjo është një vendim marrje politike.Komisioni Teknik ka dalë me një vendim dhe ky është vendimi I komisionit Teknik pra teknikët janë andej mbrapa dhe ne jemi pjesa politike.ne shohim pak më larg se pjesa teknike prandaj jemi zgjedhur nga qytetarët të gjithë,për këtë pjesë.Sesi vendoset 20%,30% ,40%,a miratohet e gjithë lista.Ne Këshilli Bashkiak e vendosim ta miratojmë të gjithë listën dhe pastaj banka bën punën e vet,procedurat ligjore,ministria e miraton, nuk e miraton është çështje tjetër ajo.Ne ktu flasim të gjithë politikisht,teknikët kanë fol pjesa teknike.Nqs duhet të sqarohet prapë teknikisht,teknikët janë aty,ktu është vendim politik.

Ilirjan Sadiku-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ne votojmë që ajo listë të mos preket,lista e parë.E kalojme atë që mos pengojnë njëra tjetrën ato

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Lista që ka ardhur projekt vendimi me 86 kuota duhet të kalojë. Ka ardhur një vendim nga drejtoria përkatëse dhe jemi të detyruar ta hedhim në votim, ta votojmë, ta rrëzojmë ta votojmë ta bëjmë si të duam pastaj me pjesën tjetër le ta diskutojmë të gjithë e të gjejmë një formë se si ta bëjmë prandaj ju thash e kalojmë këtë listën me 86 familjet që i përmbushin ligjërishr dhe ekonomikisht të gjitha kushtet

Afrim Qosja-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Nqs e kalojmë projekt vendimin siç është, a kemi hapsirë ligjore ne që të japim hapsirë brenda këtij viti, nqs do miratojmë atë listë çfarë do marim vendim më mbrapa? Te pjesa që thatë ju për të miratuar listën siç është projekt vendimi. E miratuam listën po sa hapsirë kemi pas miratimit të kësaj liste për ti dhënë hapsirë pjesës së dytë të listës

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Po votojmë listën fituese Afrim, prej fajit tënd nuk mund të digjet gjithë lagjja po e zëm se do na kthehet nesër pse duhet të kthehen gjithë të tjerët. Une them që të miratojmë këtë që është në rregull edhe e kalojmë vendim këshilli psh 106 dhe vendimin tjetër 106/1. Ta diskutojmë këtë pjesë

Enerjeta Ferra – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Skemi pse bëjmë ndarje dy lista ne, 1+1, e kalojmë të gjithë listën.

Ilirjan Sadiku-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Enerjeta në rast se ty të quhet shkelje e dyta ti ke të parën

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Unë me këtë mendim jam, e hedhim në votim të parën kush është pro? Me 86 familjet me të cilat përfitojnë.

Këshilli Bashkiak me 34 vota pro, - kundër, 2- abstenim, miraton sa më sipër.

(A.Shtylla;E.Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala 

Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja

Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.07.2025, ora 12:15 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kalon vendimi për 86 familjet, tani diskutojmë. Ishim te vendimi I pjesës së dytë çfarë vendimi do marrim për të vendosur një tavan, që çfarë do të ndodhi me ta mos të penalizohet lista e parë

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Ka një gjë që ne sot duhet të marrim një vendim ose nuk do e miratojmë listën e dytë, lista e parë kaloi me 86 familje që kanë plotësuar dhe kriterin ligjor edhe atë ekonomik. Lista e dytë nuk ka plotësuar kriterin ekonomik por ka plotësuar kriterin ligjor. Për kriterin ligjor ne jemi këtu të gjithë koshientë që duhet bërë pra kush nuk ka plotësuar kriterin ligjor të skualifikohet. Diskutimi është kjo që janë me kriter ekonomik, ne sot ose duhet të miratojmë të gjithë pra hyn tek pjesa vendim marrëse ose duhet të miratoni dhe të mbani vendimin e komisionit

Ilirjan Sadiku-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Duhet të them këtë që këto kritere që janë ndërkohë janë vendosur për të na mbajtur nën kontroll që ne mos e tejkalojmë me lista apo ka një parim tjetër që është vendosur ndaj kriterit se ai që skualifikohet për një mijë lekë skualifikohet, kjo është. Ata burra që e kanë vendosur kishin frikë se mos tejkalonim limitet?

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Gjithmonë ka një limit por ka procedura, të paktën sa kam diskutuar unë me bashki të tjera. Shumë bashki të tjera e miratojnë listën siç I vjen dhe nqs ti plotëson dokumentacionin ligjor e çojnë në bankë dhe pastaj banka merr vendimin e vet përkatës. Ne e kemi ndjekur procedurën tamam siç e kërkon VKM-ja pra kemi vendosur kriteret kemi ngritur komisionin, komisioni ka vënë kriteret ligjore dhe ka bërë dhe vlerësimin e vet përkatës. Kush është pa kriter ligjor e ka skualifikuar që në fillim që është tek lista e 3, kush është kualifikuar që plotëson edhe kriterin ekonomik edhe atë ligjor është tek lista 1 dhe kush plotëson kriterin ligjor ka mbi nivel ekonomik është tek lista e 2. Tani ky është vendimi i këshillit, këtë po diskutojmë, do miratojmë me dokumentacionin ligjor dhe do të themi kriteri ekonomik për ne është pjesë e formulës dhe angazhimit apo do e miratojmë, kjo është vendim marrje politike. Duhet marrë sot nuk e shtyjmë dot këtë për të marrë një listë tjetër se është një vendim marrje, është një procedurë e cila është hapur për vlerësim

Indrit Abdij-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Unë se kuptoj pse shtëngoheni? Banka ka kriteret e veta, ne si anëtarë këshilli nuk e kuptoj pse shtëngohemi për disa njerëz që do përfitojnë mbi banesën, ku qëllimi i jetës së shumë njerëzve është krijimi i banesës dhe se kuptoj pse. Përveç anës

morale ka anë politike,ka një përgjegjësi qytetare kështu që ajo që unë propozoj është që të kalojë e gjithë lista duke qenë se kriteret ligjore janë,dhe kriteret ekonomike janë shumë pranë atyre që janë përcaktuar nga ministria kështu që I japim njerëzve mundësinë edhe I kalojmë

Hektor Çiftja -Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Këshilltar një pyetje kisha unë pse është vendim politik ky?

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Eva cili ishte propozimi juaj?

Eva Bica -Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Përtej kësaj listës që miratuar të vendosim edhe listën tjetër,të vendosim një limit kush i tejkalon të ardhurat me 30%

Enerieta Ferra – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kto janë marrë indekset e vitit 2023,mos I shiko tani të ardhurat e këtyre.Në 2026 kriteret do ndryshojnë do ketë tjetër nivel,është banka ajo që vendos

Luan Rama -Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ne në dorë e kemi përderisa ato I kan plotësuar kriteret ne duhet ti japim një shans.Unë jap mendimin që ta kalojmë

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kam një propozim 5 minuta pushim për të diskutuar si grup dhe për 5 minuta kthehem prapë.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Çfarë propozimi kanë anëtarët e këshillit?

Eva Bica -Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Atëherë pas diskutimeve ne propozojmë që lista e cila e skualifikuar duke parë që disa familje janë shumë afër limiteve minimale apo maksimale të të ardhurave.Propozojmë që të vendosim një shtesë prej 30.000 lek të reja për familje në mënyrë që të përfitojnë edhe të tjerë meqë kemi kuota të lira

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kush është pro propozimit?

Këshilli Bashkiak me 26 vota pro, 1 kundër, 8 abstenim, miraton sa më sipër.

(E.Ferra)

(A.Marku;L.Hasa;B.Çopja;A.Shtylla;A.Meçja;N.Meta;D.Çepa;Z.Muzhaqi)


Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kalon propozimi që bëri antarja e këshillit Eva,që lista e skualifikuar për problemet e të ardhurave të lejohet deri në 30.000 lekë të reja pra I bie sipas listës janë gati 41 familje të tjera që shpresojmë të përfitojnë

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.07.2025, ora 12:15 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi,Sekretari I Këshillit Bashkiak Z.Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z.Gledian Llatja, anëtarë të KB,specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 6 e rendit të ditës

6.Shtesë e të ardhurave të trashëguara dhe shpenzimeve në buxhetin e vitit 2025

Emanuela Beluli-Përfaqësues I Administratës

Meqënëse ligjërisht buxheti miratohet në 25 Dhjetor,të ardhurat dhe shpenzimet e trashëguara parashikohen në përafërsi sepse nga data 26 deri në dt 31 ne vazhdojmë arkëtojmë të ardhura dhe shpenzime dhe për më tej Ministria e Financave ka disa vite që me një udhëzim të saj thesari kalon veprime për llogari të datës 31 Dhjetor gjithë muajin Janar kështu që mbasi mbyllen veprimet e vitit ne jemi të detyruar të rishikojmë të ardhurat dhe shpenzimet e trashëguara nga 2024.Në këtë material ju keni gati 138 milion lekë të ardhura të trashëguara po kështu edhe shpenzime.Veç kësaj janë edhe gati 10 milion lekë që Ministria e Financave I ka sjellë mbas miratimit të buxhetit për menaxhimin e mbetjeve.Dhe kështu kjo shumë duhet të përfshihet në buxhet dhe tu shkojë materialeve për menaxhimin e mbetjeve,duke ruajtur destinacionin.Gjithashtu ju keni edhe një pikë në fund për transferim fondesh.Janë disa teprica prokurimesh nga investimet po kështu edhe fonde të lira,disa fonde të lira pagash përfshirë fondin e veçantë dhe fondin e humbjes së vendeve vakante për shkak të ristrukturimit të Bashkisë dhe e gjithë kjo tepricë e fondeve shkon për mbylljen e disa detyrimeve të palikujduara gjatë vitit 2024

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kush është pro?

Këshilli Bashkiak me 28 vota pro, - kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

(D.Çepa)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.07.2025, ora 12:15 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 7 e rendit të ditës

7.Mbi miratimin e dokumentacioneve strategjike :Planit të përshtatjes ndaj ndryshimeve Klimatike.

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Ashtu siç e dimë të gjithë ka patur një ndryshim klimatik vitet e fundit. Është bërë një studim ,një projekt edhe me ndihmën e Ministrisë së Mjedisit, Turizmit dhe Mjedisit, UNDP dhe Green Found, është bërë studim për masat që duhet të merren nga 2025 deri 2040. Janë disa të dhëna, sot është momenti që duhet të veprojmë për ndryshimet klimatike. Jemi qytet industrial kemi marrë një sërë masash, po bëhemi gati për të firmosur edhe kontratën klimatike me projektin e Bashkimit Europian, me zero city që quhet projekti. Janë një sërë fondesh që na është hapur drita jeshile për të aplikuar për shumë nga projektet tona, për më shumë do flasi edhe ekspertja përkatëse e cila është marrë me gjithë projektin.

Laureta Dibra-Menaxhere projekti

Përshëndetje, unë jam Laureta Dibra dhe jam menaxhere projekti. Ka qenë një proces i suksesshëm i zhvilluar në 8 Bashki të vendit, një prej të cilave është edhe Bashkia e Elbasanit, e përzgjedhur mbi bazën e një analize territoriale që u konsiderua si një ndër Bashkitë më të prekura të vendit për shkak të ndryshimeve klimatike. Disa nga rreziqet kryesore që lidhen me rritjen e temperaturave dhe ndryshimi i reshjeve për periudhat e ardhshme flasim për vitet 2050 dhe 2100 të cilat projeksionet u zhvilluan mbi bazën e një protokolllogjie shkencore të bazuar në panelin joqeveritar për ndryshimet klimatike e cila u përshkallëzua në rajonin në nivel global, në nivel kombëtar dhe në nivel lokal. Sipas saj temperaturat e ardhshme deri në vitin 2050 në pranverat mesatare rriten me 2 gradë për qytetin e Elbasanit dhe rreth 6 gradë për temperaturat maksimale ndërkohë që niveli mesatar ditor i reshjeve do të ulet nga 6-13% për vitet 2050-2100 dhe niveli i reshjeve intensive të cilat çojnë në përmbajtje, në rebeshe do të rritet me 16-17%. Thënë kjo duke konsideruar sitë të thuash rreziqet por dhe shkallën e ekspozimit të sektorëve prioritarë siç janë bujqësia, industria, pyjet. Zhvillimi i turizmit dhe zhvillimi urban u konsideruan të çiltra le të themi, problematikat të cilat lidheshin dhe me aftësitë me kapacitete adaptuese. U vlersuar vunerabiliteti cënushmëria e këtyre sektorëve dhe mbi bazën e një metodologjie të caktuar u përcaktuan sektorët më të riskuar dhe nënsektorët përkatës dhe mbi bazën e kësaj u identifikuan masat përshtatëse. U identifikuan rreth 47 masa nga të cilat 17 janë të riskut shumë të lartë, 13 të sikut të lartë dhe pjesa tjetër risk i ulët. Mbi këtë bazë masat adaptuese u identifikuan një përzierje masash të cilat quhen sot masa të lehta por dhe masa infrastrukturore të cilat u identifikuan

me një pjesmarrje shumë aktive të bazuar në evidence, e dhën kjo nga ekspertët e Bashkive dhe me këtë rast unë dua të falenderoj për përkushtimin e tyre gjatë gjithë këtij procesi për sigurimin e të dhënave të cilat u kërkuan nga ana e ekspertëve bazuar në formularët e caktuar dhe mbi këtë bazë janë identifikuar masa shumë të rëndësishme që lidhen me parandalimin e erozionit, erozioni tokësor në zona specifike gjeografikisht të përcaktuara të Elbasanit të cilat ju I keni në planin përkatës. Gjithashtu masa që parandalojnë erozionin nga të dyja anët e Shkumbinit dhe një sërë masash të tjera infrastrukturore që lidhen me përmirsimin e rrjetit në kanalizimet e qytetit për të parandaluar përmytjet për shkak të rebesheve. Gjithashtu edhe masat që lidhen me parandalimin e thellësirave kështu që unë mendoj ashtu sikurse tha edhe kryetari është një plan është një vlerë e shtuar për planet e këtij qyteti, të zhvillimit dhe për të besuar rreziqet dhe risqet që do të vijnë në të ardhmen për shkak të ndryshimeve klimatike dhe për të rritur mundësitë dhe kapacitetet përthithse të fondeve qoftë fonde kombëtare edhe nga ato ndërkombëtare. Ajo që është e rëndësishme është që ne një sërë prej ktyre masave infrastrukturore I kemi integruar për planin kombëtar të cilin jemi duke e përfunduar tashmë dhe në muajin Shtator ne kemi për të zhvilluar një konferencë kombëtare ku do të ftojme përsëri edhe Kryetarët e Bashkive përkatëse për të lançuar planin kombëtar të përshtatjes ku kemi integruar një sërë masash përshtatëse infrastrukturore me qëllim për të gjithë kto masa të bëhen të aksesueshme ndaj fondeve që do të sigurojë qeveria Shqiptare për implementimin e tyre në nivel kombëtar dhe në nivel lokal. Faleminderit!

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ka ndonjë pyetje? E hedhim në votim kush është pro?

Këshilli Bashkiak me 35 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar i Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.07.2025, ora 12:15 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 8 e rendit të ditës

8. Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së Z. Vangjel Taqi Prifti banor në lagjen "Visarjon Xhuvani", nr 4 dhe dhënien e kompesimit nga ana e Bashkisë Elbasan.

Këshilli Bashkiak me 36 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.07.2025, ora 12:15 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtore nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 9 e rendit të ditës

9. Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së Z. Kujtim Hasan Sulejmani banor në lagjen "11 Nëntori", nr 5 dhe dhënien e kompesimit nga ana e Bashkisë Elbasan.

Këshilli Bashkiak me 36 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.07.2025, ora 12:15 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 10 e rendit të ditës

10. Mbi shpërndarjen e fondit financiar të mbrojtjes civile të vitit 2025 për familjet e dëmtuara nga fatkeqsi natyrore dhe dhënien e ndihmës financiare nga ana e Bashkisë Elbasan.

Këshilli Bashkiak me 32 vota pro, - kundër, 2 abstenim, miraton sa më sipër.

(D. Çepa; A. Shtylla)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.07.2025, ora 12:15 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 11 e rendit të ditës

11. Për ndryshimin e vendimit të Këshillit Bashkiak nr 64 datë 30.05.2025 të "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2025"

.

Këshilli Bashkiak me 32 vota pro, - kundër, 4 abstenim, miraton sa më sipër.

(A. Shtylla; E. Muzhaqi; A. Meçja; L. Hasa)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.07.2025, ora 12:15 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 12 e rendit të ditës

12. Për miratimin në parim të dhënies së pëlqimit për lejimin e shtrirjes së rrjetit inxhinjrik të furnizimit me ujë kurativ termal në prane shtetërore (rrugë, pyll, përrua etj) në njësinë Administrative Tregan.

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Është një procedurë standarte ku ato që kanë marrë lejen për shfrytëzimin e ujërave përdorin tokën për të kaluar buzë rrugës dhe në parcelat që është pronë shtet. Është një procedurë e cila ndiqet në vazhdimësi në fakt, kemi patur disa vendime të Këshillit Bashkiak që janë miratuar në vazhdimësi kto, bizneset është biznes I zonës së Treganit, të ujërave të llixhave që I vjen në ndihmë normalisht kalon një segment toke kalon nga territori I Bashkisë Elbasan që është në pronësi të Bashkisë së Elbasanit, ku janë pronësi private normalisht marrin miratimin nga pronari privat.

Këshilli Bashkiak me 35 vota pro, - kundër, abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.07.2025, ora 12:15 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 13 e rendit të ditës

13. Për një shtesë në vendimin e VKB nr 16 dt 29.01.2025 “Për miratimin e normave dhe kriterëve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorrike në administrim të ASHPR”.

Këshilli Bashkiak me 28 vota pro, - kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

(E. Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.07.2025, ora 12:15 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 14 e rendit të ditës

14. Për miratimin e akt-dhurimit të mjetit teknologjik për largimin e mbetjeve me targa AB 194 UJ me tonazh 12 ton

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Është bërë një donacion në fakt, kemi një biznes Rozafa në fakt. Ne i kemi kërkuar bizneseve në fakt që të kenë përgjegjësi sociale dhe të ndihmojnë edhe ndërmarrjen e punëve publike, edhe qytetin edhe shkollat për gjërat që na duhen por edhe për ndihmat që ne na duhen. Është përgjigjur njëri nga bizneset Rozafa Shpk e cila na është përgjigjur me dhurimin e një automjeti për pastrim teknologjik, për pastrimin e mbetjeve i cili na shërben shumë për zonat rurale aty ku ndërmarrja e punëve publike e bën vet pastrimin e fshatrave. Është një vlerë e shtuar, e kishim të domosdoshme. Nuk do mjaftohemi vetëm me këtë, na duhen përsëri mjete të tjera. Në fakt siç ne e kemi parashikuar për të ofruar një shërbim të mirë dhe cilësor në të gjitha fshatrat dhe në të gjitha zonat rurale. Ky është një mjet teknologjik i cili ishte goxha i mirë dhe na ndihmon për tërheqjen e Njësive Administrative tonat për mbetjet urbane. Është një gjë positive duhen vlerësuar këto nisma të bizneseve dhe këto përgjigje që bëjnë bizneset për përgjegjësinë e tyre sociale ndaj Bashkisë edhe komunitetit. Ishte mjet i mirë, është i euro 5 dhe është ndër më të mirët që ne kemi në flotën tonë të pastrimit të mbetjeve.

Këshilli Bashkiak me 35 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 01.07.2025, ora 12:15 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Tek të ndryshmet janë dy pika

Bianka Çopja -Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Të lutem mund ta marr unë fjalën? Ndjesë që po e marr fjalën tani po meqë erdha pak me vonesë dhe mbledhja kishte filluar. Dua të di proçesverbalin I mbledhjes së kaluar kaloi me sa vota të lutem? 28 ok. Edhe ju Zoti Luti jeni në dijeni të asaj që ka ndodhur në mbledhjen e kaluar ku pas shqyrtimeve të pamjeve filmike në fjalën time është vendosur zhurmues dhe nuk e di në c'baza e keni nxjerrë këtë proçesverbal dhe kur e hap për ta lexuar tani është vetëm pjesa pa zhurmuesin. Nuk e di nëse kjo është normale dhe e quani normale apo ktheheni pas në kohë ku nuk na lejohet as e drejta e fjalës. Mund të ma thoni pak si e keni zbardhur këtë

proçesverbal?Sepse tek shkrimi nuk është,është vetëm pjesa pa zhurmues.Zoti kryetar nëqoftëse ju duket normale...Administrata dhe gjithë këshilli duhet të jetë në dijeni patjetër se nuk bëhet asgjë pa të drejtën tuaj.Më thoni pak a është normale?

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Normalisht që nuk është normale,nuk e di pse ka ndodh se nuk duhet të ndodhi.Nuk jam në gjendje të them kjo është ashtu kjo është kështu,rradhës tjetër ta shpjegoj

Bianka Çopja -Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Zoti Luti ju keni patur gjithë kohën sepse ju kam vënë në dijeni që në momentin që unë e kam marrë materialin të plotë dhe ju kam vënë në dijeni që në fjalën time është vendosur zhurmues.Fjala nuk është as e Administratës as personale as e askujt kështu që duhet të keni kujdes me veprimet që bëni sepse mbani përgjegjësi

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Nuk besoj se ka ndodhur e sduhet të ndodhi

Bianka Çopja -Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Jo ka ndodhur sepse e keni materialin mbi të gjitha.Të lutem kisha edhe një pikë të dytë,në dijeninë time sipas të dhënave të bëra publike dhe planet e shpallura punimet për investimin në rrjetin e ri të ujësjellësit kanë mbaruar në prill.Duke qen se tani jemi në fillim të korrikut punimet ende nuk kanë përfunduar,kam disa pyetja të drejtpërdrejta:A mund të na paraqitet e detajuar një skemë e ecurisë së punimeve deri ditën e sotme?Dhe cili është progresi real në përputhje me afatet kontraktuale?

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Zonja këshilltare në lidhje me këtë që po kërkon është mirë 5 ditë apo 7 ditë përpara mbledhjes ti bësh me shkrim

Bianka Çopja -Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Jo ky është në studime të ndryshme dhe ju duhet ta keni patjetër përgjigjen dhe mbi të gjitha cilat janë faktorët që kanë sjellë kto vonesa të ndryshme,janë

administrative,janë financiare,janë teknike?Dhe kur parashikohet afati real I përfundimeve të ktyrë punimeve

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pra janë dy pyetje që të thashë,është mirë ta jenë me shkrim nga drejtoritë përkatëse që duhet të japin përgjigjet përkatëse

Bianka Çopja -Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Cili është roli konkret I mbikqyrjes teknike nga ana e Bashkisë Elbasan për kto punime?Se besoj që ktë duhet ta keni përgjigje se nuk është se punoni kot dhe nuk I dini afatet që ka përfunduar kontrata në prill dhe në jemi në fillim korriku.Se ne vazhdojmë me tym me punime dhe bëjmë një shfaqje të turpshme para të gjithëve vizitorëve që na vijnë

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Kur bëhen punime normalisht,kanë filluar punime për ujësjellësin dhe realisht është një investim I mirë.Praktikisht po punohet tek depo e qytetit dhe prioritet ujësjellësi I ka vënë në fakt edhe nënkontraktori dhe nga informacioni që kemi në I ka përqendruar forcat tek depot.Depot janë kryesore në fakt sepse hapja e tyre dhe rikonstruksioni I tyre kërkonte kohën e vet dhe ne po I kërkojmë llogari për pjesën e depove dhe përfundimin e rikonstruksionit të depove qendrore të qytetit.Ditën e djeshme është hapur depoja e Armsit,është hapur një pjesë e depos së Krastës madhe dhe po vazhdohet dalëngadalë çdo ditë duke punuar e duke I vendosur në punë depot të cilat janë restauruar.Është e vërtetë që ka një shqetsim të shtuar përse I përket edhe punimeve që po kryhen në qytet,janë punime ciklike të cilat nuk janë vetëm tek një rrugë por duhet të mbyllet një cikël I tërë punimesh dhe të provohen tubat nëse e mbajnë presionin apo jo.Është një çështje teknike,inxhinjerike.Patjetër që shqetsimi I qytetarëve është I drejtë sepse është bërë kohë që një pjesë e rrugëve janë hapur dhe presin të kalojnë ciklin e vet të maturimit të vendosjes së testit.Sipas inxhinierëve të ujësjellësit një pjesë e tyre është vënë në punë duke filluar në zonën mbrapa Imperialit,vazhdon puna për vendosjen e tyre në vazhdimësi lagje pas lagje.Premtimi jon ka qenë dhe do të mbetet që të kemi ujë 24 orë në zonat qendrore ku po bëhet investimi,janë hequr linjat e paligjshme dhe do të hiqen linjat dytësore shumë shpejt.Është një punë që po vazhdohet po punohet,ne po e monitorojmë procesin dhe kemi një përgjegjësi të shtuar sidomos

tani gjatë periudhës së verës.Kemi marrë masa administrative ndaj subjekteve zbatuese,kemi implementuar bashkëpunim edhe me Ndërmarrjen tonë të Punëve Publike edhe me kompaninë e cila pastron qytetin,bën pastrimin e rrugëve kryesore në mënyrë periodike çdo të dielë kur ka një qarkullim më të ulët të trafikut dhe të qarkullimit të qytetarëve.Ne jemi duke e ndjekur situatën nga afër,kontratat janë çështje të cilat zgjaten,nuk mund të lihen punët e qytetit përgjysëm,janë arsye të tjera dhe gjehen zgjidhje të tjera ligjore për të gjithë procesin I cili normalisht është zgjatur pak por ne jemi në fazën që nuk mund ti lejmë dot rrugët pa mbyllur kjo është e sigurt

Bianka Çopja -Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Është vendosur një afat I ri zyrtar kur do mbarojnë?

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Kan kërkuar nga Akumi,kan bër kërkesat e veta mesa di unë për zgjatjen e kontratave për kushtet për problematikat që janë hasur për punimet e parashikuara që mund të jenë gjetur problematika të caktuara dhe sipas lejes së ndërtimit ato janë në afat sipas lejes së ndërtimit

Bianka Çopja -Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Kanë përfunduar që në prill nuk janë në afat.Duhet të kishin përfunduar në prill të gjitha punimet e ujësjellësit dhe asfaltimet e rrugëve,jemi në korrik nuk jemi në afat.I keni edhe në shpalljet tuaja ligjore,të gjitha afatet kanë përfunduar në prill duhet të kishte mbaruar asfaltimi dhe rrjeti I ri I ujësjellësit.Jemi në fillim korriku dhe kemi një qytet me një pamje të tmerrshme,me pluhur punime kudo

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Ka ngarkesë por nga ana tjetër edhe po mbyllen një pjesë e lagjeve të brendshme

Bianka Çopja -Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Jemi në fillim korriku dhe do të thotë që e gjithë vera do na kalojë me pluhur,përveç vapës do të durojmë edhe pluhurin nëpër rrugë,rrugë të shkatërruara dhe askush nuk mban përgjegjësi.Ku është përgjegjsia ktu?Ju thoni brenda afateve po kjo është kundra afateve

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Tani nëqoftëse do një interpelancë për këtë, të sjellim teknikët se besoj nuk është as momenti, nuk I kemi as letrat ktu. Nëqoftëse do ta thuash për muhabet thuaje, nëqoftëse do interpelancë me ujësjellësin

Bianka Çopja -Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Zoti kryetar po ju pyes ju si përfaqësues I Bashkisë Elbasan

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Po e monitorojmë procesin gjatë të gjithë kohës për këtë të jesh e sigurt

Bianka Çopja -Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Atëhere do kalojmë verë në pluhur dhe turistët do kënaqen me pluhurin dhe shkatërrirën në qytet. Këtë I ofroni Elbasanit dhe ujë 24 orë skeni për të patur asnjëherë. Faleminderit!

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Faleminderit dhe ju zonja Bianka, faleminderit dhe për sygjerimet

Ergys Muzhaqi -Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Unë I bashkohem shqetësimit që ngre kolegja ime Bianka. Jo më larg se sot përballë derës ku po bëhet mbledhja po hapet një kanal I ri, po punohet çarje asfalti dmth është kanal I ri. Ky është një shqetësim, e kuptoj që mund të keni ardhur të papërgatitur për detaje teknike ligjore. Unë do ti bashkohem sygjerimit tuaj, kërkoj një interpelancë në mbledhjen e ardhshme. Kërkoj interpelancë me përfaqësuesit e firmave dhe të Bashkisë që të na informojë cilat kanë qenë proceset ligjore dhe teknike dhe pse qyteti është ktu sot pra jemi në korrik e akoma kemi çarje, hapje kanalesh të reja etj

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Tubat e ujit nuk kalojnë nga shtyllat, që të jemi të qartë për këtë dmth nuk ka një system që kalon nga shtylla, nga toka kalon. Përsa kohë kalojnë në tokë do hapet, ideja është të vendoset një standart siç ka qenë

Ergys Muzhaqi -Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Unë po ju mbështes në sygjerimin tuaj.Kemi për detyrë ti themi qytetarve pse po zgjatemi kaq shumë.Është apo jo normale kjo situatë,që e parë nga jashtë nuk është normale po ndoshta në interpelancë teknikët dhe juristët që do na sillni do të jenë të aftë që do na paraqesin ne si këshilltarë dhe sigurisht edhe banorëve të ktiy qyteti që pse është situatë ktu ku është.Ju lutem mbledhjen e ardhshme llogarisni interpelancën si çështje.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ok.Përveç ktyre ne kishim menduar dhe 2 informacione të cilat kanë të bëjnë me masat e marra nga Bashkia dhe drejtoritë përkatëse përsa I përket mbrojtjes nga zjarri dhe sistemin e vaditjes.Informacionin e keni në dosje

Te ndryshme

1.Informacion për mbrojtjen nga zjarri.

2.Informacion mbi sistemin e vaditjes.

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Në fakt doja të bëja një kërkesë kryetar për përgjegjshmërine e të gjithë qytetarëve pasi jemi në periudhë thatësireKemi patur zjarre të shtuara,kishte një zjarr ditën e shtunë në Fshatin Bujares.Ishte një zjarr I cili mori përmasa dhe u ndesh ndërhyrja e 4 punonjësve zjarrfikse për ta fikur dhe patjetër të vullnetarëve .Ndërkohë sot momentalisht që po flasim kemi një zjarr në Balëz I cili nuk është zjarr natyror,është zjarr I qëllimshëm.Nuk dua që në këtë periudhë të nxehti asnjë nga qytetarët të bëj djegie të pakontrolluara të mbetjeve të bujqësisë.Është shumë e rrezikshme dhe na ka sjellë dëme të vazhdueshme.Kemi qen në vazhdimësi në kontakt me policinë e shtetit për të gjithë personat përgjegjës që të dalin para ligjit,të gjithë ato që nga pakujdesia apo me dashje kanë shkaktuar zjarre të cilat kanë bër një dëm ekonomik dhe ndotin mjedisin.Do ju kërkoja shumë të gjithve që antarët e Këshillit në zonat e veta të bëjnë njoftimet përkatëse.Kryepletqë janë njoftuar që të jenë në gadishmëri dhe patjetër që është një problematikë e shtuar pjesa e zjarreve në këtë periudhë.Faleminderit!

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Faleminderit kryetar,faleminderit të gjithve.Ditën e mirë!

Mbledhja përfundon në orën 13:42

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja

